



Njoftim për shtyp

Më 14 maj 2023 shqiptarët do t'u drejtohen kutive të votimit për të zgjedhur pushtetin vendor që do të drejtojnë 61 bashki për katër vitet e ardhshme. Në këto zgjedhje do të zgjidhen 61 kryetarë bashkish si dhe 1619 këshilltarë.

Albania Community Assist e mbështetur nga Fondacioni Westminster për Demokraci dhe Ambasada Britanike, së bashku me 44 Organizata të Shoqërisë Civile vlerësojnë se këto zgjedhje janë shumë të rëndësishme për përcaktimin e rrugës së vendit për ndërtimin e një shoqërie demokratike funksionale. Nisur nga kjo qasje, Organizatat e Shoqërisë Civile nënshkruese i drejtohen të gjitha subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet vendore të 14 Majit me një Deklaratë Publike.

Po ashtu, nëpërmjet kësaj Deklarate, organizatat e shoqërisë civile, duke vlerësuar ndikimin e votuesve në zgjedhjen e strukturave vendore, i bëjnë thirrje publikut në përgjithësi dhe në veçanti votuesve në të 61 bashkitë

Ne besojmë se mbrojtja dhe garantimi i mirëfunksionimit demokratik të organeve të qeverisjes vendore është jetike për të ardhmen dhe demokracinë në vend dhe se të gjithë duhet të kontribuojmë për arritjen e saj. Integriteti është një faktor i rëndësishëm si për administrimin e zgjedhjeve të lira dhe të drejta, ashtu edhe për pjesëmarrjen e partive politike, kandidatëve, grupeve të interesuara dhe të votuesve. Kandidimi i figurave me të shkuar të dyshimtë është kosto për vetë partitë politike që i kandidojnë, por në radhë të parë është cenim i demokracisë dhe rendit kushtetues.

Jemi të bindur se zgjedhjet e lira, të drejta, konkurruese, transparente, gjithëpërfshirëse janë të rëndësishme për të siguruar legjitimitetin e të zgjedhurve vendor dhe garanci për një qeverisje vendore më pranë komunitetit dhe që ndikon drejtëpërdrejtë në përmirësimin e jetesës së tij.

Kjo deklaratë mbështetet në kuadër të projektit **“Ndërtimi i integritetit zgjedhor dhe qëndrueshmërisë së partive politike”** zbatuar nga Fondacioni Westminster për Demokraci, financuar nga FCDO nëpërmjet Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar në Tiranë, ka për qëllim të mbështesë partitë politike që të bëhen gjithnjë e më të qëndrueshme ndaj ndikimeve malinje dhe korruptive.

